Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 20 janar 2012

Lënda nr. 32/08

Bozhidarka FELEGI

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 20 janar 2012, me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 30 qershor 2008 dhe është regjistruar më 18 korrik 2008.

2. Më 14 nëntor 2008, Paneli kërkoi nga ankuesja të dorëzojë informata shtesë. Ankuesja është përgjigjur më 22 dhjetor 2008.

3. Më 16 prill 2009, Paneli kërkoi informata nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP). AKP-ja është përgjigjur më 18 maj 2009.

4. Më 7 tetor 2009, Paneli ftoi ankuesen t'i dorëzojë komentet e saj mbi informatat e marra nga AKP-ja. Sipas informatave të marra më vonë nga ankuesja, ajo nuk e kishte marrë atë letër.

5. Më 29 dhjetor 2010, Paneli kërkoi përsëri disa qartësime nga ankuesja. Më 15 janar 2011, ankuesja është përgjigjur.

6. Më 10 mars 2011, Paneli kërkoi informata shtesë nga AKP-ja. Më 14 mars 2011, AKP-ja është përgjigjur.

7. Më 11 maj 2011, Paneli ftoi ankuesen t'i dorëzojë komentet e saj mbi informatat e reja të marra nga AKP-ja, dhe kërkoi informata shtesë nga ajo. Burri i ankueses është përgjigjur më 23 nëntor 2011.

II. FAKTET

8. Ankuesja është banore e Kosovës, e cila tani jeton në Serbi. Më 13 qershor 1999, duke u frikësuar nga armiqësitë, ankuesja dhe burri i saj u larguan nga Kosova.

9. Ankuesja është pronare e një banese në Gjakovë. Pak kohë pas largimit të saj, ajo e mori vesh se banesa e saj ishte uzurpuar ilegalisht dhe dëmtuar nga autorë të panjohur.

10. Burri i ankueses është pronar i një pjese të tokës komerciale në rajonin e njëjtë. Pak kohë pas largimit të tij, ai u kthye për të kuptuar që toka ishte duke u shfrytëzuar nga individë të panjohur.

A. Procedurat para Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Agjencisë Kosovare të Pronës

11. Më 18 mars 2002, burri i ankueses, me sa duket në emër të ankueses, i dorëzoi një kërkesë Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) për njohjen e të drejtës së pronësisë për banesën. Më 30 prill 2005, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) konfirmoi të drejtën e saj të pronësisë.

12. Më 29 mars 2006, me kërkesën e ankueses, DÇPB -ja ekzekutoi nxjerrjen jashtë të uzurpatorëve ilegalë nga banesa, por as ankuesja e as burri i saj nuk i morën çelësat.

13. Më 18 tetor 2007, burri i ankueses kërkoi nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ta marrë banesën e lartpërmendur nën administrimin e vet. Më 17 korrik 2008, ai nënshkroi një marrëveshje me AKP-në, që banesa të përfshihej në skemën e AKP-së të dhënies me qira vullnetarisht. Marrëveshja përfshin një pikë në të cilën thuhet, në mesin e kushteve të tjera, që bartësi i së drejtës së pronësisë do ta marrë qiranë sapo përkatësisht nëse qiraja i paguhet AKP-së.

14. Më 14 mars 2011, AKP-ja i konfirmoi Panelit që banesa ishte ende nën administrimin e saj, duke shtuar që deri në atë datë AKP-ja nuk ishte në gjendje të japë me qira pronën, dhe që si pasojë nuk ishte mbledhur kurrfarë qiraje.

15. Në ndërkohë, më 18 tetor 2007, një kërkesë e bërë nga burri i ankueses është regjistruar nga AKP-ja, për njohjen e së drejtës së tij të pronësisë në një pjesë të tokës komerciale të pretenduar nga ai.

16. Sipas informatave të marra nga AKP-ja, gjatë informimit fillestar fizik për pronën e pretenduar kishte ndodhur një gabim, dhe për pronën u bë riinformimi përmes publikimit të 17 qershorit 2010. Kërkesa tani është duke u shqyrtuar. Në një fazë të

mëvonshme do t'i paraqitet Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) për të marrë vendim.

17. Sipas informatave të marra nga ankuesi, pjesa e tokës është shitur në ndërkohë, gjoja për një çmim më të ulët.

B. Padia para Gjykatës komunale

18. Më 12 gusht 2004, ankuesja paraqiti një padi në Gjykatën Komunale të Gjakovës kundër Komunës së Gjakovës, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar në banesë që kap shumën prej 20,000 eurosh.

19. Përafërsisht 17,000 padi për kompensime janë paraqitur në vitin 2004 pranë gjykatave të Kosovës, shumica dërrmuese e tyre nga serbët e Kosovës të cilët, për shkak të armiqësive, i kishin lënë shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve ishte dëmtuar dhe shkatërruar më vonë. Me synimin për të përmbushur afatin kohor pesëvjeçar sipas ligjit për dorëzimin e padive civile për kompensim, këta paditës dorëzuan paditë e tyre rreth datës së njëjtë në vitin 2004. Paditë ishin të drejtuara kundër kombinimit UNMIK, KFOR, IPVQ dhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (më tej PKDNJ), *Millogoriq dhe të tjerët* , lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendimi i 24 marsit 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën paditësit e bazuan padinë e tyre, shih mendimin e njëjtë, § 5).

20. Për sa i përket këtyre rasteve, drejtori i Departamentit të Drejtësisë i UNMIK-ut (DD) u dërgoi një letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe rajonale dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 26 gusht 2004. Në letër, drejtori i DD-së theksoi që "mbi 14,000" padi të tilla janë paraqitur. Ai iu referua "problemeve që një vërshim aq i madh i padive do t'u shkaktojë gjykatave", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos parashihet në orar, derisa të përcaktohet së bashku më së miri koha e duhur për të kryer shqyrtimin e këtyre rasteve" (për tekstin e plotë të letrës, shih *Millogoriq dhe të tjerët* mendimi, i përmendur në § 19 më lart, në § 6).

21. Më 15 nëntor 2005, DD-ja u kërkoi gjykatave që të fillojnë me shqyrtimin e padive për dëmet e shkaktuara nga personat e zakonshëm të identifikuar dhe dëmet e shkaktuara prej tetorit të vitit 2000, duke pasur parasysh që "pengesat për shqyrtimin efikas të këtyre rasteve" nuk ekzistonin më. Paditë e ndërlidhura me ngjarjet që ndodhën para tetorit të vitit 2000 nuk preken nga kjo letër.

22. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD-së këshilloi gjykatat që rastet që nuk janë futur në orar për shqyrtim sipas kërkesës së 26 gushtit 2004, tani duhet të shqyrtohen.

23. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

24. Më 15 janar 2011, ankuesja deklaroi që padia e saj në atë kohë ishte ende në pritje për t'u zgjidhur para Gjykatës Komunale të Gjakovës.

III. ANKESA

25. Ankuesja ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurave para DÇPB / KKPB, në lidhje me banesën e saj. Për sa i përket kësaj, ajo mbështetet në shkelje të së drejtës për një vendim të gjykatës brenda një kohe të arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ajo gjithashtu pohon që duke mos marrë ndonjë qira për banesën e saj sipas skemës së AKP-së për qira, e drejta e saj në pronë, e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, është shkelur.

26. Ankuesja më tutje ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurave para AKP-së, në lidhje me pjesën e tokës të burrit të saj. Në lidhje me këtë ajo prapë mbështetet në shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

27. Në fund, ankuesja ankohet rreth faktit që Gjykata Komunale e Gjakovës i ka ndalur procedurat në lidhje me kërkesën e saj për kompensim, për shkak të dëmtimit të pronës së saj. Paneli konsideron që ankuesja thirret në shkelje të së drejtës të marrë një vendim brenda një kohe të arsyeshme, e garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së, dhe gjithashtu të së drejtës për kompensim efektiv, e garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së.

IV. APLIKIMI I RREGULLËS 29*BIS* TË RREGULLORES SË PUNËS SË PANELIT

28. Paneli thekson që ankesa ngrit pyetjet të cilat, së paku aq sa ankesa ka të bëjë me procedurat e nisura në vitin 2004 para Gjykatës Komunale të Gjakovës, në esencë janë të njëjta me ato që janë ngritur, mes tjerash, në lëndët nr. 38/08, *Millogoriq*, 58/08, *Zhivaleviq*, 61/08, *Gojkoviq*, 63/08, Ç*ukiq*, dhe 69/08, *Bogiçeviq*, të cilat tanimë janë shqyrtuar nga Paneli. Për më tepër, duket nga dosja që nuk ngritet asnjë çështje e re e pranueshmërisë në lidhje me atë aspekt të rastit në fjalë. Prandaj, në pajtim me rregullën 29*bis* të Rregullores së punës së Panelit, Paneli gjen që nuk është e nevojshme t'i komunikohet UNMIK-ut kjo pjesë e ankesës. Paneli konsideron që mund ta shqyrtojë pranueshmërinë e krejt ankesës pa e bërë atë.

V. LIGJI

29. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet së pari të vendosë nëse do ta pranojë ankesën, duke pasur parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të 23 marsit 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

A. Ankesa në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të ndërlidhura me pronën e ankueses pranë Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore/Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, dhe në lidhje me administrimin e asaj prone nga Agjencia Kosovare e Pronës

30. Ankuesja ankohet në rend të parë rreth kohëzgjatjes së procedurave në lidhje me të drejtën e pronësisë në banesën e saj.

31. Ankesa në lidhje me banesën i është dorëzuar DÇPB-së më 18 mars 2002. Më 7 qershor 2005, KKPB nxori vendimin e vet. Siç është sqaruar më tutje nga AKP-ja, ai vendim u ekzekutua më 29 mars 2006, kur uzurpuesi ilegal u nxor jashtë nga banesa.

32. Ankesa aktuale iu dorëzua Panelit më 30 qershor 2008, apo më shumë se gjashtë muaj pas vendimit përfundimtar në procedurat e DÇPB-së /KKPB-së dhe më shumë se gjashtë muaj pas zbatimit të atij vendimi.

33. Nga kjo rrjedh që kjo pjesë e ankesës është e papranueshme, pasi që është dorëzuar jashtë afatit, në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

34. Ankuesja ankohet më tutje për shkelje të së drejtës së saj në pronë, si rezultat i mospagesës së qirasë për banesën e saj sipas skemës së AKP-së për qira.

35. AKP-ja sqaron që prona është vendosur nën administrimin e saj më 14 nëntor 2007, me kërkesën e burrit të ankueses, dhe është përfshirë në skemën vullnetare të qiradhënies më 17 qershor 2008. Ajo sqaron më tutje që nuk ishte në gjendje ta lëshonte me qira banesën dhe për atë arsye nuk është mbledhur qiraja.

36. Ankuesja nuk i kundërshton këto fakte.

37. Paneli rikujton që AKP-ja, kur e merr pronën nën administrim të saj, nuk garanton që do të realizohet ndonjë e ardhur nga prona, apo madje që do të gjendet qiramarrësi që paguan qiranë të banojë në pronë. Pagesa mund t'i bëhet pronarit vetëm nëse qiramarrësi ia paguan qiranë AKP-së (shih PKDNJ, *Trajkoviq*, nr. 35/08, vendimi i 17 shkurtit 2009, § 20).

38. Ankesa dhe informatat e mëvonshme të marra nuk përmbajnë asnjë dëshmi që mbështesin konkluzionin që e drejta e ankueses për mbrojtje të pronës ishte shkelur për shkak të dështimit të AKP-së për të dhënë me qira pronën apo për të paguar ndonjë shumë të caktuar ankueses për qiranë (shih PKDNJ, *Trajkoviq*, nr. 35/08, përmendur më lart, në § 21; shih gjithashtu PKDNJ, *Zhivkoviq*, nr. 29/08, vendimi i 26 nëntorit 2010, § 36; PKDNJ, *Sokoli*, nr. 14/08, vendimi i 17 marsit 2011, § 27).

39. Prandaj, Paneli është i mendimit që kjo ankesë duhet hedhur poshtë si qartë e pabazuar në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

B. Ankesa në lidhje me procedurat që kanë të bëjnë me pronën e burrit të ankueses, para Agjencisë Kosovare të Pronës

40. Ankuesja gjithashtu ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurave që kanë të bëjnë me një pjesë të tokës që pretendon se i takon burrit të saj.

41. Nga sqarimet e AKP-së del që ankesa ishte regjistruar nga AKP-ja më 18 tetor 2007 dhe ishin marrë informata fizikisht më 2 shtator 2008. Ankesa ishte publikuar më 7 nëntor 2008 (*KPA Gazette*, nr. 17, nëntor 2008). Ajo nuk u kontestua brenda periudhës prej 30 ditësh nga publikimi. AKP-ja pastaj bëri verifikimin e dokumenteve të dorëzuara nga burri i ankueses në mbështetje të ankesës së tij. Meqë autenticiteti i këtyre dokumenteve nuk mund të verifikohej, paraqitësit iu kërkua të sigurojë dokumente shtesë. Është zbuluar më vonë, mesa duket pas konsultimit të regjistrimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që është bërë një gabim gjatë njoftimit fizik për ankesën. Si rezultat, për ankesën është bërë riinformimi përmes publikimit më 17 qershor 2010 (*KPA Gazette – Njoftim*, nr. 2, qershor 2010). Më 14 mars 2011, AKP-ja i shkroi Panelit që procesi i verifikimit ka përfunduar dhe që ankesa ishte duke u trajtuar për vendim të KKPB-së.

42. Ankuesja nuk konteston faktet e paraqitura nga AKP-ja.

43. Paneli thekson që, për sa i përket kontrollit administrativ të UNMIK-ut mbi AKP-në, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në raportin e tij për Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të datës 17 mars 2009, deklaron që pasi autoriteti i UNMIK-ut mbi AKP-në nuk është zgjatur pas 31 dhjetorit 2008, autoritetet e Kosovës dhe një drejtor ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian morën kontrollin e plotë operacional të AKP-së. Pas kësaj, AKP-ja veproi në pajtim me legjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës (S/2009/149, § 24; shih PKDNJ, *Kushiq*, nr. 08/07, mendimi i 15 majit 2010, § 51).

44. Veç kësaj, në *Kushiq* (përmendur më lart, në § 52) Paneli tanimë konsideron që nga 31 dhjetori 2008, UNMIK nuk mund të mbahet më përgjegjës për aktet apo mosveprimet për të cilat fajësohet AKP-ja.

45. Për sa i përket periudhës ndërmjet 18 tetor 2007 dhe 31 dhjetor 2008, duket që gjatë asaj periudhe për ankesën ishte njoftuar fizikisht më 2 shtator 2008 dhe ishte publikuar më 7 nëntor 2008.

46. Duke marrë parasysh numrin e madh të kërkesave dorëzuar AKP-së, Paneli konsideron që gjatë asaj periudhe kishte vonesë të një kohëzgjatjeje të tillë që tejkaloi kërkesën për kohë të arsyeshme. Prandaj, Paneli e konsideron këtë pjesë të ankesës, në lidhje me periudhën e cekur, të jetë qartë e pabazuar në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

47. Për sa i përket periudhës pas 31 dhjetorit 2008, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

C. Ankesa në lidhje me procedurat para Gjykatës Komunale të Gjakovës

48. Paneli konsideorn që, përderisa ankuesja pohon shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ-së, ajo në fakt bën dy ankesa (shih qëndrimin e miratuar, në mes tjerash, në *Millogoriq*, nr. 38/08, vendimi i 22 majit 2009; krahaso Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *Açimoviq kundër Kroacisë*, nr. 48776/99, vendimi i 30 majit 2000; GJEDNJ, *Kutiq kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, vendimi i 11 korrikut 2000). Në njërën anë, ajo ankohet rreth faktit që për shkak të ndaljes së procedurave në gjyqin kompetent, ajo nuk ka qenë në gjendje të marrë vendim për pretendimin e saj për kompensim, për shkak të dëmit ndaj pronës së saj. Paneli konsideron që kjo ankesë mund të ngritë një çështje të së drejtës së saj për qasje në një gjyq sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së dhe së drejtës së saj për kompensim efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ-së. Në anën tjetër, ajo ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurave para gjykatave kompetente, për shkak të faktit që parashtresat u paraqitën në vitin 2004, dhe që kërkesa e saj nuk është shqyrtuar që nga ajo kohë. Kjo ankesë mund të ngrisë çështjen e së drejtës së saj për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

49. Paneli konsideron që ankesa sipas neneve 6 § 1 dhe 13 e KEDNJ-së ngrit çështje serioze të fakteve dhe ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon që kjo pjesë e ankesës nuk është qartë e pabazuar në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih, në mes tjerash, PKDNJ, *Millogoriq*, i përmendur në § 48 më lart, në § 18).

50. Nuk është provuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur këtë pjesë të ankesës të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

- I SHPALL TË PRANUESHME ANKESAT NË LIDHJE ME TË DREJTËN E QASJES NË GJYQ DHE TË DREJTËN NË KOMPENSIM EFEKTIV (NENET 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT) DHE TË DREJTËN PËR VENDIM GJYQËSOR BRENDA KOHËS SË ARSYESHME (NENI 6 § 1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT), PËR SA I PËRKET PARASHTRESAVE TË PARAQITURA NË VITIN 2004 NË GJYKATËN KOMUNALE TË GJAKOVËS;

- E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues